



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 8

4 shkurt

2014

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 1, datë 23.1.2014	Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për Reformën Administrative-Territoriale në Republikën e Shqipërisë.....	155
Udhëzim i MAS nr. 1, datë 13.1.2014	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 17, datë 31.7.2012 “Për procedurën e pranimit dhe të regjistrimit në programet e studimeve të ciklit të parë dhe të dytë, me kohë të plotë, të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë privat, si edhe për transferimin e studimeve për vitin akademik 2012-2013” dhe udhëzimin e ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 14, datë 9.7.2013 “Për procedurën e pranimit dhe të regjistrimit në programet e studimeve të ciklit të parë dhe të dytë, të ofruara nga institucionet private të arsimit të lartë, si edhe për transferimin e studimeve në këto institucione për vitin akademik 2013-2014”, të ndryshuar.....	156
Urdhër i MD nr. 61, datë 22.1.2014	Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e klinikave ligjore vendore, si dhe për ofrimin prej tyre të ndihmës juridike parësore”.....	157
Urdhër i MPB nr. 38, datë 28.1.2014	Për delegimin dhe disa rregulla të përfaqësimit ligjor të Ministrisë së Punëve të Brendshme.....	159
	Vendim (i shkurtuar) për shpalljen të zhdukur të shtetasit Nevruz Harizaj.....	161
	Vendim (i shkurtuar) për shpalljen të zhdukur të shtetasit Dritan Brahimi.....	161

VENDIM
Nr. 1/2014

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË POSAÇËM PËR REFORMËN
ADMINISTRATIVE-TERRITORIALE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 77, pika 1 të Kushtetutës dhe të nenit 24 të rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrative-Territoriale në Republikën e Shqipërisë.

II. Komisioni i Posaçëm ka për objekt të veprimtarisë së tij:

- a) përcaktimin e kriterëve për ndarjen e re administrative-territoriale në Republikën e Shqipërisë;
- b) hartimin dhe përcaktimin e kalendarit të zbatimit të reformës administrative-territoriale;
- c) përgatitjen e projektit për ndarjen e re administrative-territoriale në Republikën e Shqipërisë.

III. Komisioni i Posaçëm ngrihet mbi bazën e barazisë pozitive-opozitive. Në përbërje të tij do të ketë 16 anëtarë, nga të cilët, 8 janë përfaqësues të pozitës (6 PS dhe 2 LSI) dhe 8 përfaqësues të opozitës (6 PD, 1 PR dhe 1 PDIU). Emrat e anëtarëve të tij përcaktohen me vendim të Kuvendit.

IV. Komisioni i Posaçëm do të kryesohet nga dy bashkëkryetarë, 1 nga pozita, PS dhe 1 nga opozita, PD.

V. Komisioni i Posaçëm do të zhvillojë veprimtarinë e tij në një afat kohor 3-mujor, nga data 24.1.2014 deri në datën 24.4.2014. Në rast nevojë, me kërkesë të arsyetuar të bashkëkryetarëve të tij, Kuvendi vendos zgjatjen e afatit të ushtrimit të veprimtarisë së komisionit.

VI. Pranë Komisionit të Posaçëm ngrihet dhe funksionon grupi i ekspertëve, numri, afatet e punës dhe detyrat specifike të të cilëve përcaktohen me vendim të komisionit.

VII. Komisioni i Posaçëm, në veprimtarinë e tij, do të zhvillojë konsultime dhe seanca diskutimi me ministrin e Shtetit për Çështjet Vendore, me përfaqësues të qeverisjes vendore dhe të shoqatave të zgjedhura vendore, ekspertë të fushës, të shoqërisë civile dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare që mbulojnë çështjet e qeverisjes vendore.

VIII. Çdo parti tjetër parlamentare, e cila nuk është e përfshirë në këtë komision, ka të drejtë të bëjë propozime.

IX. Prezenca e Bashkimit Evropian, Këshillit të Evropës, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, Programi për Qeverisjen Vendore (PLGP/USAID), si dhe organizatat e tjera ndërkombëtare, me përvojë në çështjet e qeverisjes vendore, ftohen të ndjekin dhe të japin asistencë dhe ekspertizë teknike në punimet e komisionit dhe grupit të ekspertëve të ngritur pranë tij.

X. Mbledhjet e komisionit janë të vlefshme, kur në to janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij. Vendimmarrja e komisionit do të synojë të arrijë konsensusin për të gjitha propozimet e marra. Vendimet e komisionit do të quhen të miratuara me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të komisionit, mbështetur mbi konsensusin e arritur midis pozitës dhe opozitës.

XI. Ngarkohen Kryetari i Kuvendit dhe sekretari i përgjithshëm për krijimin e kushteve të punës dhe mbështetjen logjistike të veprimtarisë së këtij Komisioni të Posaçëm.

XII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir META

Miraturar në datën 23.1.2014



UDHËZIM

Nr. 1, datë 13.1.2014

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN E MINISTRIT TË ARSIMIT DHE SHKENCËS NR. 17, DATË 31.7.2012 “PËR PROCEDURËN E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË DHE TË DYTË, ME KOHË TË PLOTË, TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË PRIVAT, SI EDHE PËR TRANSFERIMIN E STUDIMEVE PËR VITIN AKADEMIK 2012-2013” DHE UDHËZIMIN E MINISTRIT TË ARSIMIT DHE SHKENCËS NR. 14, DATË 9.7.2013 “PËR PROCEDURËN E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË DHE TË DYTË, TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET PRIVATE TË ARSIMIT TË LARTË, SI EDHE PËR TRANSFERIMIN E STUDIMEVE NË KËTO INSTITUCIONE PËR VITIN AKADEMIK 2013-2014”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 112 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” dhe nenit 33 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Pika 3, germa “a” e udhëzimit të ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 17, datë 31.7.2012, ndryshon si më poshtë:

“Diplomën e Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose diplomën; dëftesën e shkollës së mesme të fituar jashtë vendit, të vlerësuar të barasvlershme me të në Shqipëri; dëftesë pjekurie të shkollës së mesme (për kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 876, datë 3.11.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike” (të ndryshuar)”, origjinali ose fotokopje të saj, të konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore DAR/ZA).”.

2. Në pikën 5 të udhëzimit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 17, datë 31.7.2012, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“IAL-të private i dërgojnë Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP), në formë shkresore dhe elektronike (në *hardcopy* dhe në CD), brenda datës 31 janar 2014, listën e kandidatëve të regjistruar në vitin akademik 2012-2013, të cilët kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 876, datë 3.11.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike” (të ndryshuar)”. AKP-ja, brenda datës 28 shkurt 2014, u dërgon IAL-ve private listën përkatëse me numrat e matricullimit të studentëve.”.

3. Pika 3, paragrafi i parë, i udhëzimit të ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 14, datë 9.7.2013 (të ndryshuar), ndryshon si më poshtë:

“Kandidati që ka përfunduar shkollën e mesme, si dhe është pajisur me diplomën përkatëse në Republikën e Shqipërisë, për të realizuar aplikimin, duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:”.

4. Pika 3, germa “a” e udhëzimit të ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 14, datë 9.7.2013 (të ndryshuar), ndryshon si më poshtë:

“Diplomën e Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose fotokopje e noterizuar e diplomës, e konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA).

Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 876, datë 3.11.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike” (të ndryshuar), paraqesin dëftesën e pjekurisë (origjinali ose fotokopje të saj të konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore DAR/ZA).”

Në qoftë se kandidatët nuk zotërojnë dëftesë pjekurie të shkollës së mesme, duhet të paraqesin dublikatë të dëftesës së pjekurisë, të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme ku kanë përfunduar

shkollën, të konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA) ose dokumentin e lëshuar nga Arkivi i Shtetit së bashku me listën e notave.”.

5. Në pikën 9 të udhëzimit të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës nr. 14, datë 9.7.2013 (të ndryshuar), shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“IAL-të private i dërgojnë Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP), në formë shkresore dhe elektronike (në *hardcopy* dhe në CD), brenda datës 31 janar 2014, listën e kandidatëve të regjistruar në vitin akademik 2012-2013, të cilët kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 876, datë 3.11.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike” (të ndryshuar)”. AKP-ja, brenda datës 28 shkurt 2014, u dërgon IAL-ve private listën përkatëse me numrat e matricullimit të studentëve.”.

6. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen sekretari i përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Arsimore dhe Planifikimit Strategjik, Agjencia Kombëtare e Provimeve, si dhe institucionet private të arsimit të lartë.

7. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla

URDHËR

Nr. 61, datë 22.1.2014

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR FUNKSIONIMIN E KLINIKAVE LIGJORE VENDORE, SI DHE PËR OFRIMIN PREJ TYRE TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të nenit 12/1, pika 4 të ligjit nr. 10 039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”, të ndryshuar, me propozim të Komisionit Shtetëror për Ndhimën Juridike,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e klinikave ligjore vendore, si dhe ofrimin e ndihmës juridike parësore”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Komisioni Shtetëror për Ndhimën Juridike për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Nasip Naço

RREGULLORE

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR FUNKSIONIMIN E KLINIKAVE LIGJORE VENDORE, SI DHE PËR OFRIMIN PREJ TYRE TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave të funksionimit të klinikave ligjore vendore, si dhe të ofrimit prej tyre të ndihmës juridike parësore.

Neni 2

Qëllimi

Kjo rregullore ka si qëllim përcaktimin e rregullave të hollësishme për mënyrën e funksionimit të klinikave ligjore vendore, si dhe procedurat për ofrimin e ndihmës juridike parësore në përputhje me



parimet e barazisë së të drejtave për të gjithë individët, që përfitojnë nga ndihma juridike, profesionalizmit, cilësisë, eficiencës, efektivitetit të shërbimit të ndihmës juridike, ruajtjes së konfidencialitetit dhe papranushmërisë së konfliktit të interesit.

Neni 3

Llojet e shërbimeve të ofruara

Klinikat ligjore vendore ofrojnë ndihmë juridike parësore në format e mëposhtme:

- a) japin informacion për sistemin ligjor në Republikën e Shqipërisë;
- b) japin informacion për aktet normative në fuqi;
- c) japin informacion mbi të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit, mënyrat e ushtrimit të të drejtave të individit në proceset gjyqësore dhe ato jashtëgjyqësore;
- d) japin asistencë në hartimin e dokumenteve juridike apo në forma të tjera këshillimi të grupeve në nevojë;
- e) japin asistencë për plotësimin e kërkesës për përfitimin e ndihmës juridike dytësore, si dhe dokumenteve që duhet t'i bashkëlidhen formularit tip të kërkesës.

Neni 4

Kompetencat e klinikave ligjore

Kompetencat e klinikave ligjore janë si më poshtë:

- a) organizimi, menaxhimi dhe administrimi i procedurave dhe i programeve të hartuara nga Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike;
- b) ndihmesa e kërkuarit për plotësimin e formularit tip të kërkesës;
- c) sigurimi i dokumenteve të nevojshme për plotësimin e kërkesës për përfitimin e ndihmës juridike dytësore, të përcaktuara në vendimin nr. 3, datë 25.6.2011 "Për miratimin e formularit të kërkesës për përfitimin e ndihmës juridike dhe dokumentet që duhet t'i bashkëngjiten formularit tip të kërkesës";
- d) vendosin mbi të drejtën e kërkuarit për përfitimin e ndihmës juridike parësore;
- e) vendosin nëse ndihma e kërkuar është brenda fushës së shërbimeve të ndihmës juridike;
- f) komunikimin e vendimeve, politikave dhe procedurat e Komisionit të të gjitha institucioneve dhe palëve të interesuara;
- g) raportimin pranë Komisionit Shtetëror për Ndhmën Juridike sa herë kërkohet;
- h) edukimin ligjor të publikut, përmes ndihmës që i ofrohet komunitetit me klinika lëvizëse, publikime, fushata televizive dhe në medien e shkruar, si dhe masa të tjera të ngjashme, duke u kushtuar vëmendje të veçantë problemeve të grupeve më në nevojë.

Neni 5

Vendndodhja

Klinikat ligjore vendore do të krijohen në rrethet: Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë.

Neni 6

Paraqitja dhe dorëzimi i kërkesës për dhënien e ndihmës juridike

Kërkuari apo përfaqësuesi i tij i autorizuar me prokurë, që kërkon dhënien e ndihmës juridike parësore, mund ta paraqesin dorazi ose me postë pranë klinikës ligjore vendore. Kërkesa për dhënien e ndihmës juridike parësore nuk i nënshtrohet asnjë forme. Ajo mund të paraqitet edhe verbalisht pranë personit të autorizuar. Personi i autorizuar pranë klinikës ligjore plotëson formularin tip të kërkesës me të dhënat e aplikuesit, si dhe llojin e shërbimit të ofruar për qëllime statistikore sipas aneksit nr. 1 që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje dhe është përbërëse e saj. Personi i autorizuar plotëson formularin tip të kërkesës për qëllimet statistikore.

Neni 7

Vërtetësia e informacionit

Në rast se konstatohet dhënia e informacionit të pavërtetë në formularin për dhënien e ndihmës juridike ose pavërtetësi në informacionin e dhënë në dokumentet që i bashkëngjitet këtij formulari, ky fakt përbën shkak për ndërprerjen e menjëhershme të ndihmës juridike dhe sipas rastit mund të përbëjë shkak për përgjegjësi penale sipas dispozitave përkatëse të Kodit Penal.

ANEKSI NR. 1

MODELI I FORMULARIT TIP TË KËRKESËS PËR DHËNIEN E NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE

Emri	
Mbiemri	
Atësia	
Amësia	
Datëlindja (dita, muaji, viti)	
Vendlindja	
Seksi	
Shtetësia	
Vendbanimi (adresa e saktë)	
Lloji i dokumentit identifikues	
Numri i dokumentit identifikues	
Numri i telefonit	
Adresa e e-mail-it	
Lloji i shërbimit të kërkuar:	Vendosni shenjën X
Sigurim i informacionit juridik	
Dhënia e këshillave dhe e shpjegimeve të çështjeve juridike, intervistave të drejtpërdrejta apo komunikimit në distancë	
Plotësimi i akteve të ndryshme juridike	
Dhënia e këshillave juridike për personat që e kryejnë vetëpërfaqësimin në gjykatë	

URDHËR

Nr. 38, datë 28.1.2014

PËR DELEGIMIN DHE DISA RREGULLA TË PËRFAQËSIMIT LIGJOR TË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 27 dhe neneve 121 e 124 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në proceset gjyqësore kur thirret si palë në një gjykim, lëshohen për aparatën nga sekretari i përgjithshëm, në emër të personit që do të përfaqësojë ministrinë.

2. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Punëve të Brendshme kur thirret si palë në gjykim, në proceset gjyqësore, në të cilat institucioni i varësisë ka lidhje me objektin e padisë, lëshohen në emër të personit që do të përfaqësojë ministrinë, nga drejtuesi i institucionit qendror ose i atij territorial të varësisë, sipas vendit ku është ngritur kërkesëpadia.

3. Modeli i autorizimit për përfaqësimin në proceset gjyqësore të jetë sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri.

4. Përfaqësimi për çdo proces gjyqësor bëhet nga juristë dhe specialistë të fushës për të cilën është ngritur kërkesëpadia (sipas rastit nga njësia e personelit apo njësia tjetër përgjegjëse brenda institucionit), nëpërmjet autorizimit të lëshuar nga autoritetet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij urdhri.



5. Përfaqësimi ligjor i Ministrisë së Punëve të Brendshme në proceset gjyqësore, sipas këtij urdhri, i jep të drejtë përfaqësuesit të autorizuar të kryejë çdo veprim procedural, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, në kuadër të përfaqësimit në shkallën përkatëse të gjykimit.

6. Përfaqësuesit e caktuar të ndjekin me korrektësi seancat gjyqësore, për sa i takon pjesëmarrjes së tyre e, veçanërisht kontributit provues, paraqitjes së kërkesave, prapësimeve, pretendimeve, ankimeve, rekurseve, si dhe dokumenteve të tjera, që do të ndihmonin mbrojtjen e përpiktë të interesave të institucionit të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

7. Në përfundim të proceseve gjyqësore, në çdo shkallë të gjyqësorit, brenda një afati 5-ditor nga shpallja/njoftimi i vendimit, të paraqitet informacion i detajuar, i shoqëruar me vendimet përkatëse në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

8. Ngarkohen të gjitha institucionet e varësisë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, qendrore dhe territoriale, të caktojnë një person përgjegjës që do të jetë pikë kontakti për të shkëmbyer çdo njoftim për ecurinë dhe ndjekjen e proceseve gjyqësore.

9. Për autorizimet e lëshuara nga sekretari i përgjithshëm deri në miratimin e këtij urdhri, të cilat janë përdorur ose përdoren për përfaqësim në proceset gjyqësore, efektet e urdhrit nr. 636, datë 5.11.2013 “Për delegim kompetence”, do të shtrihen edhe pas miratimit të këtij urdhri, deri në përfundimin e procesit gjyqësor.

10. Ngarkohen institucionet e varësisë së Ministrisë së Punëve të Brendshme, drejtoria që mbulon çështjet juridike për aparatën dhe sekretari i përgjithshëm për zbatimin e këtij urdhri.

11. Ngarkohet sektori i arkiv-protokollit për njoftimin e këtij urdhri institucioneve të varësisë të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

12. Urdhri nr. 636, datë 5.11.2013 “Për delegim kompetence”, si dhe çdo dispozitë e përcaktuar në urdhra të tjerë, që bie në kundërshtim me këtë urdhër, revokohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
Saimir Tahiri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
(Sekretari i përgjithshëm/institucioni i varësisë)

Nr. ___ prot.

(vendndodhja), më __ . __ .2014

AUTORIZIM

PËR PËRFAQËSIMIN NË ÇËSHTJEN ADMINISTRATIVE/CIVILE ME PALË:

Paditës:

E paditur:

Objekti:

Në mbështetje të neneve 64-77 të Kodit Civil, të nenit 96 të Kodit të Procedurës Civile, të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, si dhe të urdhrit të ministrit të Punëve të Brendshme nr., datë “Për delegimin dhe disa rregulla të përfaqësimit ligjor të Ministrisë së Punëve të Brendshme”,

VENDOSA:

Autorizimin e z./znj, me detyrë, për të përfaqësuar Ministrinë e Punëve të Brendshme për të hartuar, nënshkruar dhe dorëzuar ankimin/rekursin në të gjitha seancat gjyqësore të çështjes administrative/civile me objektin e sipërcituar, deri në shpalljen e vendimit në (gjykatën kompetente për gjykimin e mosmarrëveshjes përkatëse).

(Sekretari i përgjithshëm/drejtuesi i institucionit)



VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr. 1431, datë 26.12.2013, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Nevrus Harizaj, i biri i Sulos dhe i Selimesë, i datëlindjes 9.3.1920, lindur në Sevrin, Përmet, si dhe caktimin si kujdestar të pasurive të tij, të birin, kërkuesin Shkëlqim Harizaj.

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 2706, datë 23.12.2013, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Dritan Brahimi, i biri i Hajdarit dhe i Zanes, i datëlindjes 18.7.1971, lindur dhe banues në Vlorë.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2014, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QBZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 12 lekë